



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1479/1 prot.

Elbasan, me 09.07.2021

VENDIM

Nr 29 datë 09.07.2021

"PËR

NJË NDRYSHIM NË VBA NR. 8 DATË 06.03.2021 'PËR MIRATIMIN E PLAN BUXHETIT TË VITIT 2021''

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 137 date 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE " Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 " Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", VBA nr. 8, datë 06.03.2021 "Për miratimin e plan buxhetit të vitit 2021", VBA nr. 9, datë 06.03.2021 "Për miratimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2021", Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Miratimin ndryshimeve në listën e projekteve për investime – Tabela 1;
2. Miratimin ndryshimeve në zërin e shpenzimeve operative "Udhëtim i brendshëm-Ekspedita mësimore dhe praktika në terren viti akademik 2020-2021" me 500 mijë lekë dhe kalimin në zërin "Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative" për përballimin e shpenzimeve të krijimit të shoqatës sportive studentore dhe shpenzime të tjera të përgjithshme.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Tabela 1

Nr	Emërtimi i projektit	Total Plani		Obligim nga 2020	Plan 2021		Prokurim për 2021	
		ishte	Bëhet		ishte	Bëhet	ishte	Bëhet
II	Ndërtime të reja	1,021,454	1,021,454	11,145	228,000	215,330	1,020,610	1,020,610
I	"Ndertim i godinës së Fakultetit të shkencave humane " - ish materniteti	699,455	699,455	0	180,000	167,330	699,455	699,455
	xxxxxxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx
IV	Paisje inventar ekonomik	33,221	45,890	11,145	33,221	45,890	22,076	34,746
I	Pajisje kompjuterike e fotokopje	23,000	35,670	10,044	23,000	35,670	12,956	25,626
	xxxxxxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx	xxxx

Administratori: E. Hoxha
Drejtoria ekonomike: F. Qosja



KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI